AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

KONFERENCË SHKENCORE
SCHOLARLY CONFERENCE

STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË
ALBANIAN STUDIES IN AMERICA

SHTATOR 25-26 SEPTEMBER 2015

PROGRAMI I KONFERENCËS
CONFERENCE PROGRAM

PRISHTINË PRISHTINA

Marrin pjesë/Participants:

1.Albert Riska
2.Ali Aliu
3.Anton Berishaj
4.Artur Karasinski
5.Bahri Beci
6.Bardh Rugova
7.Bardhyl Demiraj
8.Bashkim Kuçuku
9.Bavjola Shatro
10. Besim Kabashi
11. Besnik Pula
12. Blertë Ismajli
13. Brian Joseph
14. Carly Dickerson
15. Carrie Ann Morgan
16. Dhurata Shehri
17. Eqrem Basha
18. Flora Dado
19. Gianni Belluscio
20. Imri Badallaj
21. James J. Pennington
22. Jani Thomai
23. Jonida Xhyra-Entorf
24. Julie Kolgjini
25. Kastriot Marku
26. Ke Jing
27. Kolec Topalli
28. Kujtim Shala
29. Ledi Shamku-Shkreli
30. Lindita Sejdiu-Rugova
31. Mario De Matteis
32. Mehmet Halimi
33. Mehmet Kraja
34. Mimoza Priku
35. Muhamet Hamiti
36. Rexhep Ismajli
37. Rrahman Paçarizi
38. Rusana Bejleri
39. Sabri Hamiti
40. Seit Mansaku
41. Shaban Sinani
42. Shkumbin Munishi
43. Shpend Bengu
44. Teuta Abrashi
45. Valter Memisha
46. Vesel Nuhiu
47. Victor Friedman
48. Zymer Neziri

Këshilli organizues/Organizing Committee:
Rexhep Ismajli, Prishtinë
Victor Friedman, Chicago
Eqrem Basha, Prishtinë

Përgjegjës për kontakte/Contact person:
Hilmi Zogjani, Prishtinë
Tel. + 381 (0) 38 211 619
e-mail: hilmi.zogjani@ashak.org

INFORMACION RRETH KONFERENCËS

Pjesëmarrësit e Konferencës që vijnë nga jashtë do të vendosen në Hotel Sirius, në afërsi të Akademisë.

Punimet e konferencës fillojnë më 25 shtator dhe zhvillohen për dy ditë në mjediset e ASHAK-ut, ku ardhja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve pritet duke filluar nga ora 8:00. Konferenca i fillon punimet në 8:30.

Secili folës ka në dispozicion deri në 15 minuta, ndërsa pas çdo kumtese rezervohen 5 minuta diskutim.

Kumtesat e radhitura në formë elektronike i dorëzohen sekretarisë, e cila do të merret me përgatitjen për botim të vëllimit me punimet e konferencës. Për ata që kanë nevojë për rishikim jepet një afat deri më 15 nëntor 2015 për ta dorëzuar versionin përfundimtar.

CONFERENCE INFORMATION

Conference participants from abroad will be accommodated at the Sirius Hotel, Prishtina (close to the ASHAK building).

The conference will be held at the ASHAK premises on 25 and 26 September. Registration of participants will take place on 25 September, at the ASHAK main hall, starting from 8:00. The conference sessions start at 8:30.

Oral presentations will be 15 minutes in duration, with an additional five minutes allotted for questions and answers directly after each presentation.

Participants are kindly asked to submit their papers (electronic copy) to the Conference Secretariat in charge of publishing the conference materials. Those who may need additional time to review their papers can submit the final versions by 15 November 2015, at the latest.

E premte/Friday, 25 shtator/September

Drejtojnë/Moderated by: Victor FRIEDMAN, Rexhep ISMAJLI, Eqrem BASHA

8:30 Rexhep ISMAJLI, Prishtinë: Studimet albanistike në Amerikë – fjala e hapjes

8:50 Victor FRIEDMAN, Chicago: Gjuha shqipe në Amerikë: Perspektiva akademike

9:10 Sabri HAMITI, Prishtinë: Ujdhesa e shpëtimit

9:30 Brian JOSEPH, The Ohio State University: Përfytyrimi i shqipes ndër gjuhëtarët e hershëm amerikanë

9:50 Besnik PULA, New York: Studimet albanistike në Amerikë: dështimet në institucionalizim

10:10 Shaban SINANI, Tiranë: Albanian Catholic Bulletin, një dritare ndihmesash në shkencat kombëtare ndër dijetarët shqiptaro-amerikanë

10:30 Seit MANSAKU, Tiranë: Probleme të paskajores së shqipes në kontekstin e gjuhësisë ballkanike sipas veprës së studiuesit Brian D. Joseph

10:50 Vesel NUHIU, Prishtinë: Fonetika e shqipes nga G. S. Lowman

Pushim për kafe/ Coffee break

Drejtojnë/Moderated by: Jani THOMAI, Vesel NUHIU, Seit MANSAKU

11:20 Kolec TOPALLI, Tiranë: Për një shtresim kronologjik-etimologjik të leksikut fetar në poezitë e Nolit

11:40 Bardhyl DEMIRAJ, München: Për njohjen dhe zbatimin e teorisë së laringaleve IE në studimin diakronik të shqipes

12:00 Gianni BELLUSCIO, Cosenza: Dialektologu me çizme të bardha. Eric Pratt Hamp-i dhe Arbëreshët

12:20 Albert RISKA, Elbasan: Përkimet leksikore rumuno-shqiptare në këndvështrimin e Eric P. Hamp

12:40 Bardh RUGOVA, Prishtinë: Kontributi i Bevington-it për fonologjinë e shqipes – theksi si rast studimi

13:00 Teuta ABRASHI, Prishtinë: Lidhja ndërmjet kundërvënies aspektore aorist/ imperfekt dhe nyjës shquese/ joshquese

13:20 Lindita SEJDIU-RUGOVA, Prishtinë: Kundërvëniet aspektore brenda shqipes në studimet e Friedman-it dhe në studimet e sotme të shqipes

13:40 Blertë ISMAJLI, Prishtinë: Përtej mënyrës? Vështrime rreth modalitetit në raport me habitoren te Friedman

14:10-16:00 Dreka/Lunch

16:10 Drejtojnë/Moderated by: Bardhyl DEMIRAJ, Mimoza PRIKU, Bardh RUGOVA

16:00 Jani THOMAI, Tiranë: Fjalori anglisht-shqip i Leonard Newmark-ut

16:20 Rrahman PAÇARIZI, Prishtinë: Gramatika e Newmark-ut

16:40 Besim KABASHI, Erlangen: Leonard Newmark: Albanian-English Dictionary – një lexim

17:00 Jonida XHYRA-ENTORF, München: Shkoklitje socio-kulturore në "OAED" hartuar nga Newmark

17:20 Mimoza PRIKU, Shkodër: Fuqia e fjalës në fjalor: fjalësi shqip në Fjalorin shqip-anglisht të Leonard Newmark-ut

17:40 Valter MEMISHA, Tiranë: Rreth ndihmesës së Nelo Drizarit në leksikografinë anglisht-shqip e shqip-anglisht

Pushim për kafe/Coffee break

18:20 Drejtojnë/Moderated by: Kolec Topalli, Rusana Bejleri, Rrahman Paçarizi

18:20 Bahri BECI, Paris: Janet Byron për historinë e formimit të shqipes standarde

18:40 Imri BADALLAJ, Prishtinë: Janet Byron mbi bazën dialektore të gjuhës standarde shqipe dhe qëndrimi zyrtar ndaj dialekteve

19:00 Ledi SHAMKU-SHKRELI, Tiranë: Kontributi i Janet Byron

19:20 Carrie Ann MORGAN, The Ohio State University/ Tiranë: Ideologjitë gjuhësore në Tiranë

19:40 Shkumbin MUNISHI, Prishtinë: Pikëpamjet për shqipen standarde të zhvilluara në SHBA

20:00 Julie KOLGJINI, Prishtinë: Aesthetic Disruptions of Standard Language Ideology: the Case of Albanian

E shtunë/Saturday 26 shtator/September

8:30 Drejtojnë/Moderated by: Bahri BECI, Brian JOSEPH, Imri BADALLAJ

8:30 Ali ALIU, Prishtinë: Histori dhe doracak i letërsisë – rasti Elsie

8:50 Rusana BEJLERI, Sofje: Kontributi unik i albanologut kanadez Robert Elsie në botë

9:10 Mehmet KRAJA, Prishtinë: Ëndrra amerikane e shqiptarëve. Vështrim politik dhe historik mbi diasporën shqiptare në Amerikë

9:30: Bashkim KUÇUKU, Tiranë: Shkrimtari dhe diktatura, 1957-1990 të akademikut australian Peter Morgan

9:50 Kujtim SHALA, Prishtinë: Noli: historia..., revolucioni... e autobiografia

10:10 Mehmet HALIMI, Prishtinë: Funksioni semantik e artistik i kompozitave në veprimtarinë letrare të Nolit

10:30 James J. PENNINGTON, The Ohio State University: Coastal Convergence: Montenegrin impact on the grammar of Albanian speakers in Ulcinj/Ulqin

Pushim për kafe/Coffee break

11:20 Drejtojnë/Moderated by: Kujtim SHALA, Flora DADO, Ali ALIU

11:40 Flora DADO, Tiranë: Arshi Pipa, midis filozofisë së jetës dhe filozofisë së artit (Qasje kontradiktore në filozofinë e interpretimit letrar)

12:00 Bavjola SHATRO: Albanian Studies and Comparative Literature in the North American Academe

12:20 Anton BERISHAJ, Prishtinë: Arshi Pipa: Kritika politike

12:40 Dhurata SHEHRI, Tiranë: Kritika e Arshi Pipës

13:00 Kastriot MARKU, Milano: Kontributi i A. Pipës në kritikën dhe studimet letrare

13:20 Muhamet HAMITI, Prishtinë: Letërsia shqipe dhe perspektiva e A. Pipës

13:40 Ke JING, Pekin: Tjetri në veprën e Kadaresë: një qasje kino-amerikanë

14:00 Dreka/Lunch

16:00 *Drejtojnë/Moderated by*: Bashkim KUÇUKU, Zymer NEZIRI, Shkumbin MUNISHI

16:00 Zymer NEZIRI, Prishtinë: Kontributi i profesorëve amerikanë M. Peri e A. Lord për epikën gojore shqiptare

16:20 Carly DICKERSON, The Ohio State University: Burrnesha: Albanian sworn Virgins and the linguistic Expression of gender Identity

16:40 Artur KARASINSKI, Torunj: Trashëgimia gjuhësore dhe letrare shqipe në bibliotekën Newberry

17:00 Mario DE MATTEIS, Bochum: Das integrierte Fremdsprachen- und Sachfachlernen - auch ein Modell für das kosovarische Schulwesen auf dem Weg nach Europa?

17:20 Shpend BENGU, Tiranë: Kontributi i SHBA-së në dokumentimin e trashëgimisë kulturore shqiptare

17:40 Anton ÇEFA, New York: Veprimtaria e Sami Repishtit

18:00 *Drejtojnë/ Moderated by: Rexhep ISMAJLI, Victor FRIEDMAN, Eqrem BASHA*

Mbyllja e Konferencës - Closing comments

20:00 Darka e përbashkët/Dinner (all participants)

ABSTRAKTET/ ABSTRACTS

1. Albert RISKA, Elbasan: PËRKIMET LEKSIKORE RUMUNO-SHQIPTARE NË KËNDVËSHTRIMIN E ERIC P. HAMP

Në këtë artikull diskutohet mbi qëndrimin dhe ndihmesën e indoeuropianistit amerikan Eric P. Hamp lidhur me një nga problemet më interesante të listorisë së gjuhës shqipe. Është fjala për burimin e fjalëve të përbashkëta midis shqipes dhe rumanishtes, apo të atyre elementeve leksikore që (për të përdorur një shprehje të Hamp-it) nga aspekti rumun i vështrimit quhen "autoktone". Çështja e burimit të fjalëve të përbashkëta midis rumanishtes dhe shqipes është rrokur nga mjaft dijetarë të tjerë, rumenologë e albanologë, para Hamp-it e pas tij, por, duke qëndruar në pozitat e indoevropianistit, Hamp-i duket se ka gjetur çelësin e duhur, jo vetëm për të dhënë zgjidhje të pranueshme, por edhe për të çelur një shteg që vlen të ndiqet nga të tjerë.

2. Ali ALIU, Prishtinë: HISTORI DHE DORACAK I LETËRSISË

Në këtë kumtesë diskutohen sfidat e një historie të letërsisë shqipe përmes vështrimit të procedeve dhe të rezultateve që ka ndjekur Robert Elsie, të para dhe në përqasje me të tjerët.

3. Anton BERISHAJ, Prishtinë: ARSHI PIPA: KRITIKA POLITIKE

Në studimet letrare shqiptare jashtë vendit, posaçërisht ato të zhvilluara pranë qendrave të ndryshme universitare në SHBA, Arshi Pipa zë një vend të veçantë – si për nivelin akademik të studimeve të tij, ashtu edhe për metodat e zbatuara. Kjo vlen posaçërisht për qasjen e tij të veçantë nga perspektiva e sociologjisë së letërsisë dhe kritikës politike (Eagleton), si të autorëve të traditës letrare – romantike (De Rada) dhe pasromantike (Migjeni e të tjerë), por edhe të autorëve bashkëkohorë (Kadare). Kjo qasje metodologjike ia ka mundësuar Pipës që letërsinë shqipe ta shohë nga një perspektivë radikale, por njëkohësisht tradicionale dhe shpesh kontraverze. Pipa diskursin letrar e sheh në relacione specifike me politikën dhe të kushtëzuar nga ajo – d.m.th. me "mënyrën e organizimit të jetës në shoqëri dhe çështjet e shpërndarjes së fuqisë/ pushtetit".

4. Anton ÇEFA, New York: VEPRIMTARIA E SAMI REPISHTIT

Në këtë kumtesë jepet një pasqyrë e punës qytetare, përfshirë veprimtarinë për Kosovën, sidomos për të drejtat e njeriut, dhe autriale letrare e studiuese të njërit nga të shquarit të mërgatës shqiptare në Amerikë – Sami Repishtit.

5. Artur KARASINSKI, Torunj: TRASHËGIMIA GJUHËSORE DHE LETRARE SHQIPE NË BIBLIOTEKËN NEWBERRY

The paper "Trashëgimia gjuhësore dhe letrare shqipe

në bibliotekë Newberry" concerns the role of Newberry Library in Chicago and the characteristics of one of the most important linguistic and literary Collection of the Prince Louis Lucien Bonaparte. Part of the Albanian heritage that left this English linguist and dialectologist is a large number of positions of the Albanian literary classics including the beginnings of written literature as well as major works that began to appear along with the literary revival in Albanian lands and diasporas in the second half of the nineteenth century – the begging of Rilindja period. In addition to the characteristics of the most important items of this collection, in the paper would be included practical information related to access to this enormous collection and scholarships that offers Newberry Library in Chicago.

6. Bahri BECI, Paris: JANET BYRON PËR HISTORINË E FORMIMIT TË SHQIPES STANDARDE

Objekt i kumtesës sime do të jetë përcaktimi i vendit të veprës së Xh. Bajron në historinë e studimit të shqipes standarde. Vepra e saj Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës. Rasti i shqipes, u shkrua kur në ShBA problemet e planifikimit gjuhësor ishin në rend të ditës si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.

Ishte koha kur në Shqipëri përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të kohës gjuhësinë shqiptare e kishin shpallur si gjuhësi "marksiste" dhe të gjitha shpjegimet për historinë e shqipes standarde pretendohej të bëheshin mbi këtë bazë.

Ky ishte pak a shumë edhe konteksti që, në një më-

nyrë a në një tjetër, ka përcaktuar dy qëndrime në shpjegimin e historisë së formimit të shqipes standarde atë të gjuhësisë shqiptare zyrtare dhe atë të Xhenet Bajronit.

Në këtë kontekst janë bërë edhe vlerësimet e veprës saj nga përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare të kohës deri në vitin 1990.

Pikërisht pikëpamjet e saj për historinë e formimit të shqipes standarde, po edhe qëndrimet kontradiktore ndaj veprës së saj para dhe pas vitit 1990, do të jenë objekt i kësaj kumtesë kushtuar veprës së Xh. Bajron.

7. Bardh RUGOVA, Prishtinë: KONTRIBUTI I BEVINGTON-IT PËR FONOLOGJINË E SHQIPES – THEKSI SI RAST STUDIMI

Ky punim mëton të hulumtojë ndikimin e studimeve të Gary L. Bevingtonit në fonologjinë shqiptare, me vështrim të posaçëm theksin e shqipes. Bevington ka sjellë studimin e parë gjenerativ të fonologjisë së shqipes. Punimi i tij, duke mos i marrë parasysh varietetet tingullore brenda vetë shqipes, nuk i përfshin rregullat e detajuara, por vetëm vlerat binare brenda gjenerativizmit. Megjithatë, studimet e mëvonshme të teorisë së optimalitetit (Trommer, Grim 2004, Trommer 2005) mbështeten në të dhënat e Bevingtonit, ndërsa trajtimi i theksit në bazë të kësaj teorie (Bozovic 2013) vazhdon të trajtohet. Studimi, po ashtu, nxjerr në pah se puna e Bevingtonit kryesisht është kufizuar brenda sistemeve të zgjedhimit dhe të fleksionit të emrave, pa e trajtuar në plotni morfologjinë derivacionale.

Fjalët kyçe: theks, vlerë binare, infleksion, variant i fonemës, teori e optimalitetit

8. Bardhyl DEMIRAJ, LMU München: PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E TEORISË SË LARINGALEVE IE NË STUDIMIN DIAKRONIK TË SHQIPES

Vështrimi perspektiv i zhvillimeve të shkencës së indoeuropianistikës prej gjysmës së dytë të shek. XX, duke përfshirë këtu prurjet e studiuesve albanologë amerikanë (R. Minshall 1956; E. Hamp 1964, M. Huld 1984, Brian Joseph etj.) dëshmon efektivitetin e zbatimit të teorisë së laringaleve ie. në hetimin e fazave të kryehershme të evolucionit të protoshqipes si degë e veçantë e familjes indoeuropiane. Këtë përfundim e mbështesin plotësisht edhe rezultatet e studimit tonë, ku jemi fokusuar pikërisht në rrugët e zhvillimit dhe të përftimit të dysisë fonologjike /r/ ~ /rr/ në gjuhën shqipe, duke parë me këtë rast mundësinë e zbatimit të teorisë së laringaleve ie. si të vetmin opsion që ofron zgjidhje të kënaqshme.

9. Bashkim KUÇUKU, Tiranë: SHKRIMTARI DHE DIKTATURA, 1957-1990 TË AKADEMIKUT AUSTRALIAN PETER MORGAN

Monografia "Kadare, shkrimtari dhe diktatura, 1957-1990" e Profesorit të Universitetit të Sidneit (Australi), Peter Morgan, njëkohësisht drejtor i Programit për Studimet Europiane në po atë universitet, botuar në anglisht prej Maney Publishing, shtëpi botuese akademike britanike me standard të lartë, me Zyra edhe në Boston (SHBA), ndonëse nuk u përket drejtpërdrejt studimeve amerikane për gjuhën, kulturën dhe letërsinë shqipe, mendojmë, se, jo vetëm për gjuhën ang-

leze me të cilën është shkruar, por edhe për qasjen e botuesin mund të përfshihet në to. Para disa vjetësh është botuar edhe në shqip me një kulturë përkthimi dhe botimi nënvleftësuese, amatorësh. Mes disa dhjetra librave në gjuhë të huaja, që kanë objekt studimi veprën e Ismail Kadaresë, është i vetmi, me sa njohim, që vjen nga Australia, kontinenti më i largët me Shqipërinë, dhe, po ashtu, me marrëdhënie historiko-kulturore të pakta, ose të papopullarizuara deri sot. Nga tërësia e qasjeve, autori ka zgjedhur për ta parë veprën e tij përmes marrëdhënieve me censurën, problemi qeniesor/ekzistencial i krijimtarisë në diktaturë, tek e fundit, edhe i vet shkrimtarit. Monografia është ndërtuar në mënyrë polemike midis mendimit të disave, që kanë thënë, se, qëndrimi i Kadaresë në totalitarizëm ishte brenda sistemit, dhe, për pasojë, vepra në shërbim të tij, dhe, mendimit tjetër, se, pavarësisht, nga qëndrime të veçanta, "kompro-metuese", ai ka qenë kundër, dhe vepra e tij ka përcjellë mesazhe lirie dhe emancipimi. Teza e pamundësisë së disidencës, në kuptimin e mirëfilltë, ndryshe nga në vendet e tjera europiane të Lindjes staliniste, mbështetet në të dhënat tipike të censurës në Shqipëri, mënyrat e imponimit të metodës së realizmit socialist nëpërmjet formimit shkollor dhe institucioneve shtetërore, të kontrollit zyrtar e të mbikqyrjes së fshehtë, përdorimit të mendimit të lexuesit të indoktrinuar, etj. Në këto rrethana, Ismail Kadaresë, sipas tij, nuk i mbetej tjetër, veçse gjuha e Ezopit, simbolet

dhe alegoritë, nga njëra anë, të arrinte t'i botonte veprat kundër, dhe, nga ana tjetër, mos të kishte pasoja. Në dobi të këtij mendimi, që, me koherencë të madhe, përshkon monografinë, sillen fakte të shumtë biografikë, të formimit të autorit, të bindjeve, qëndrimit dhe alibive për botimin e veprave të caktuara, sidomos analiza e brendisë kundërtotalitare të tyre. "Do të ishte gabim, përfundon në mënyrë sintetike Peter Morgan, të paraqitej Kadareja si një figurë e heshtur gjatë diktaturës. ... Kadareja shkroi disa nga veprat më të shkëlqyera dhe subversive që kanë dalë nga Europa Lindore socialiste.

10. Bavjola SHATRO: ALBANIAN STUDIES AND COMPARATIVE LITERATURE IN THE NORTH AMERICAN ACADEME

This paper aims to introduce possible paths of study for Albanian Studies seen through the perspective of Comparative literature as it is practiced in North American universities, mainly in the United States of America. Emphasis will be given to the factor of language, and the particularities that make Albanian literature a very fertile ground for research, which would help introduce this literature to international readership and academe. This approach aims to highlight the potential for the developing of comparatism in Albanian Studies as a discourse that constantly questions status quos in the literary process and in the society in general.

Among the questions that the paper endeavors to

deal with are the aspects of Albanian literature that could be of interest considering the essentially interdisciplinary nature of comparative literature in North America and why this interdisciplinarity would be fruitful to Albanian Studies. Albanian Studies cannot afford to develop within the national borders or worse within state borders; nor can it afford to be self-centered and to disregard relationships to other arts, to history, philosophy, sociology and other sciences. This perspective which is quite common and stands at the heart of Comparative Literature in the United States academe would surely support the communication of Albanian Studies and Albanian literature in particular with other literatures and cultures, which is a crucial precondition to a deeper understanding of the development of Albanian literature itself as well as of a better understanding of the nature of literature. Albanian literature will not have to be seen any longer under the sole area of South-East European Literatures; instead it would become an active part of a large worldwide discourse on literature and culture, which American comparativism highly values and practices since WWII.

11. Besim KABASHI, Erlangen: LEONARD NEWMARK: ALBANIAN-ENGLISH DICTIONARY – NJË LEXIM

Fjalori shqip-anglisht i autorit Leonard Njumark (Newmark) është një vepër jo e rëndomtë në leksikografinë dygjuhësore shqip-gjuhë tjetër. Ai ngërthen në vete disa veçori të cilat e bëjnë atë ndryshe nga fjalorët e mëparshëm shqip-anglisht e kryesoret janë: (1) përfshirja e një numri të madh të zërave që nuk

shihen si pjesë e gjuhës standarde; (2) shënimi në një formë ndryshe i të dhënave morfologjike/ gramatikore; (3) përfshirja e një numri të madh të kolokacioneve dhe të frazeologjizmave; dhe (4) përfshirja e një numri të madh të zërave nga fusha të ndryshme shkencore, për herë të parë, në një fjalor të këtij lloji.

Në vijim do të shqyrtohen këto veçori, në veçanti të dhënat morfologjike/gramatikore, të cilat janë një risi në leksikografinë shqiptare dhe janë një këndvështrim i ndryshëm nga përshkrimi i tyre i deritashëm. Një pjesë shumë e vlefshme e tyre janë të sistemuara e të përmbledhura në formë udhëzuesi për lexuesin e fjalorit.

12. Besnik PULA, New York: STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË: DËSHTIMET NË INSTITUCIONALIZIM

Studimet albanistike në SHBA datojnë të paktën që nga fillimi i shek. XX. Një shtytje të madhe për ngritjen e studimeve albanistike në SHBA i dha mërgata e hershme shqiptare, e ardhur kryesisht nga jugu i Shqipërisë. Pas Luftës së Dytë Botërore nisin përpjekjet e para për institucionalizimin e studimeve albanistike në SHBA. Përkundër rezultateve në nxitjen e studimeve albanistike në SHBA gjatë viteve 1950 e tutje, këto suksese modeste në pikëpamje sasiore nuk ndiqen me suksese në institucionalizimin e studimeve albanistike në kuadër të sistemit universitar amerikan. Ky punim do t'i diskutojë disa nga përpjekjet për institucionalizimin e studimeve albanistike në SHBA dhe sfidat që vazhdojnë t'i kenë studimet albanistike në këtë drejtim.

13. Blertë ISMAJLI, Prishtinë: PËRTEJ MËNYRËS? VËSHTRIME RRETH MODALITETIT NË RAPORT ME HABITOREN TE FRIEDMAN

Diskutimi për përkatësinë e habitores si mënyrë foljore është një çështje e shtruar vetëm në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Tradicionalisht ajo përkufizohet si mënyrë e foljes që përdoret për të shprehur habi, dyshim, ironi. Studime të thelluara për funksionet e saj që janë bërë në gjysmën e dytë të shek. XX nxjerrin në pah edhe funksionin e referativitetit – bartjen neutrale të informatës nga folësi (Riza 1966, Fiedler 1966, Camaj 1969, Friedman 2004). Në këtë punim do të trajtohen qëndrimet e V. A. Friedman për funksionet e habitores së shqipes – apo sipas terminologjisë së propozuar nga Friedman jokonfirmativitetit (nonconfirmativity) si dhe studimet e tij për format e (jo)konfirmativitetit në shqipen në krahasim me gjuhët e Ballkanit dhe me gjuhët e Kaukazit. Këto studime vënë në pah fushën modale që mbulojnë format e habitores dhe tejkalojnë përshkrimin tradicional që ka për bazë qëndrimin folës. Theks i veçantë do të vendoset te trajtimi i habitores si kategori e evidencialitetit, pra si mjet për kodimin e burimit të indormatës.

Fjalët çelës: habitore, evidencialitet, modalitet, non-confirmativity

14. Brian JOSEPH, The Ohio State University: PËRFYTYRIMI I SHQIPES NDËR GJUHËTARËT E HERSHËM AMERIKANË

Në këtë artikull pasqyroj referencat e hershme për gjuhën shqipe në letërsinë gjuhësore amerikane,

duke u përqendruar kryesisht në faktin se sa dinin, apo nuk dinin amerikanët për këtë gjuhë. Shqyrtoj posaçërisht veprat e Whitney, Gray, Sturtevant, Sapir, Buck dhe Bloomfield. Fakti se gjuhëtarët amerikanë ishin pak prapa europianëve në studimet e tyre për gjuhën shqipe, natyrisht, është i kuptueshëm, por gjithsesi i shënueshëm. Ky studim jo vetëm ndihmon të kuptuarit e studimeve për shqipen, por hedh gjithashtu pak dritë mbi zhvillimin e studimeve në Amerikë.

(In this paper, I chronicle the early references to Albanian in American linguistics literature, focusing on just how much the American linguists knew -- or did not know -- about the language. I examine works of Whitney, Gray, Sturtevant, Sapir, Buck, and Bloomfield in particular. The fact that American linguists were somewhat behind the Europeans in their scholarship on Albanian is of course understandable, but is noteworthy nonetheless. This study not only adds to our understanding of scholarship on Albanian but also sheds some light on the development of linguistic scholarship in America.)

15. Carly DICKERSON, The Ohio State University:
Burrnesha: ALBANIAN SWORN VIRGINS AND THE LINGUISTIC EXPRESSION OF GENDER IDENTITY

The linguistic dimensions of transgenderism have typically been studied within qualitative frameworks, and have tended to focus on marginalized groups, such as the hijras (Kulick 1997), the travestis (Hall & O'Donovan 1996) and the 'yan daudu (Gaudio 2014). Not only are there no quantitative studies of socio-

linguistic variation in transgender speech generally, there is also a lack of research on transgender individuals who occupy prominent positions in mainstream society and are treated on par with their cisgender cohort.

This paper focuses on the linguistic aspects of the construction of masculine identities by the burrnesha (also known as 'sworn virgins') of northern Albania and Kosova: biological females who have become 'social men'. Unlike other 'third genders' (Kulick 1999), the burrnesha are motivated not by personal identity or sexual desire, but by the need to fulfil patriarchal roles within a traditional social code. Although they are accepted and treated as men in their community, burrnesha do not marry or engage in sexual relationships, and are thus seen as honourable and self-sacrificing (Young, 2000). Under these circumstances, how do burrnesha construct and express their identity linguistically, and how do others engage with this identity? Do burrnesha follow the linguistic construction of masculinity of biological males, or do they set themselves apart through the use of both male and female linguistic practices?

I examine the effects of social and linguistic factors on variation in the use of grammatical gender in the speech of burrnesha and others in their communities, based on conversations recorded in 2014 during fieldwork in Durrës, Elbasan, Shkodra, and surroundings areas. Quantitative analysis reveals that choices in the grammatical gender used to refer to burrnesha are linked to the speaker's relationship to them, the time period being referred to (pre- or post-transition), and the expression of particular traits (such as pride

or strength). Situated within a culture that embraces women becoming men, this study sheds light onto the linguistic practices used by a community in the co-construction of gender.

16. Carrie Ann MORGAN, The Ohio State University/ Tiranë: IDEOLOGJITË GJUHËSORE NË TIRANË

Që nga koha e Osmanëve, ideologjitë gjuhësore kanë përfaqësuar dy dialektet kryesore të shqipes përkatësisht me figura kulturale që karakterizohen si rurale/jo e zhvilluar/e mbyllur dhe urbane/e zhvilluar/e hapur. Në kohën e socializmit, këto figura janë përforcuar gjatë procesit të standardizimit të gjuhës shqipe. Megjithatë falë migrimit të brendshëm dhe ndryshimeve politike, ideologjitë gjuhësore kanë filluar të ndryshojnë në Shqipërinë postsocialiste, sidomos në Tiranë ku kontakti mes varieteteve të shqipes ka pësuar një rritje si rezultat i këtij migrimi. Ky studim përqendrohet tek shfaqja e ideologjive gjuhësore në diskurs si dhe në përdorimin e varieteteve të ndryshme në intervista me studentët në Tiranë. Në këtë kumtesë do të analizoj kuptimin socio-indeksues të varieteteve të shqipes dhe çka tregojnë për mënyrën në të cilën folësit ndajnë këto varietete.

17. Dhurata SHEHRI, Tiranë: KRITIKA E ARSHI PIPËS

Kumtesa do të përqendrohet në studimet e Arshi Pipës, një prej autorëve më të rëndësishëm të kritikës shqiptare. Në brendësi hulumtimi do të ndjekë këto rrugë:

- Do të tentojë një tipologjizim brendshëm të kritikës së Pipës.

- Do të analizojë disa nga tezat themelore të kritikës së Pipës dhe "rrezatimin" e tyre.
- Do të analizojë modelet kritike të pranishme në kritikën e Pipës.
- Do të krahasojë kritikën e Pipës në diasporë me kritikën "zyrtare" brenda Shqipërisë për çështje të njëjta.
- Do të analizojë ndikimin e Pipës në ndërtimin e "kanonit" letrar shqiptar.

18. Flora DADO, Tiranë: ARSHI PIPA, MIDIS FILOZOFISË SË JETËS DHE FILOZOFISË SË ARTIT (QASJE KONTRADIKTORE NË FILOZOFINË E INTERPRETIMIT LETRAR)

Në këtë referim konceptet teorike të Arshi Pipës, lidhur me kuptimin dhe interpretimin e veprës letrare, do të shihen në tre boshte themelore, në atë të filozofisë, si dije universale njerëzore, të filozofisë së artit letrar, ashtu siç e koncepton ai, dhe filozofisë së gjykimit letrar. Në këtë trekëndësh, të përfytyruar prej nesh, ku dija racionale e njeriut dhe prirja intuitive e kuptimit dhe interpretimit të gjërave krijojnë raporte sa të logjikshme aq dhe misterioze, shprehet kalimi i natyrshëm nga koncepti filozofik i Pipës mbi jetën dhe njeriun, te koncepti mbi thelbin e artit letrar dhe pastaj tek mënyra e interpretimit të letërsisë. Synimi ynë është të depërtojmë në sistemin e të menduarit filozofik dhe gjykimit letrar, të gjejmë lidhjen e brendshme midis këtyre tre llojeve të krijimit, ku, sipas tij, faktori kryesor është intuita . Vëmendja do t'i kushtohet kryesisht skajit të tretë të trekëndëshit të

sistemit teorik të A. Pipës, që ndërtohet mbi tezën: kritika unjisohet me vetë filozofinë. Në konceptin e tij studiuesi e ngre nivelin e gjykimit letrar përtej aspektit thjesht filologjik, paraqitjes se fakteve artistike të veçuara apo të sistematizuara. Në sistemin e të menduarit teorik të A. Pipës do të gjejmë mpleksjen e një varg tezash e pikëvështrimesh të letërsisë që nisin, nga shekulli XIX pozitivist, e deri në shekullin XX, ku intuitivizmi, formalizmi, hermeneutika, etj. ndeshen, qasen, largohen, për ta bërë më aktiv dhe më interesant mendimin filozofik dhe kritik mbi artin letrar. Mbi këtë bazë, synojmë të interpretojmë edhe disa kontradikta në sistemin e filozofisë kritiko-letrare të A. Pipës. Kjo jo thjesht si një dukuri e kritikueshme, por si shprehje e thelbit kompleks të letërsisë, çka reflektohet edhe në interpretimet e saj.

19. Gianni BELLUSCIO, Cosenza: DIALEKTOLOGU ME ÇIZME TË BARDHA. ERIC PRATT HAMP-I DHE ARBËRESHËT

Ishte marsi i vitit 1950 kur prof. Joshua Whatmough (1897-1964), i Universitetit të Harvard-it, i nisi një letër prof. Carlo Tagliavini-t (1903-1982) të Universitetit të Bologna-s për t'i rakomanduar një student të doktoratës, i cili shfaqte interes për studimin e shqipes dhe të dialekteve të saj. Pikërisht me atë letër dhe nëpërmjet Tagliavini-t fillojnë marrëdhëniet e Eric Pratt Hamp-it (1920) me arbëreshët. Pas asaj letre Tagliavini takon Hamp-in në Bologna dhe i propozon të shkojë për të verifikuar në terren diçka të habitshme, faktin që në Kalabri, në provincën e Kozencës, në mes të një numri të madh të folmesh me tipologji toske, ka edhe një të folme për të cilën thuhet që pa-

raqet tipare gege, e folmja e Vakaricit (Vaccarizzo Albanese). Me atë anketë që zgjati për rreth dy vjet dhe me prezantimin e disertacionit të doktoratës më 1954 nisin kërkimet, studimet, botimet, marrëdhëniet e Hamp-it për dhe me arbëreshët. Këto marrëdhënie, që do të zgjasin për plot gjashtëdhjetë vjetët e ardhshëm, kam dëshirë t'i përshkruaj dhe do të jenë përmbajtja e këtij kontributi.

20. Imri BADALLAJ, Prishtinë: JANET BYRON MBI BAZËN DIALEKTORE TË GJUHËS STANDARDE SHQIPE DHE QËNDRIMI ZYRTAR NDAJ DIALEKTEVE

Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe i vitit në Tiranë, trazoi kërshërinë e shumë gjuhëtarëve brenda trojeve shqiptare dhe jashtë tyre, sidomos normëzimi i toskërishtes, veçanërisht i toskërishtes së shkruar, shkaktoi reagime të karakterit sa shpjegues, aq edhe polemizues. Me këtë rast gjuhëtarja amerikane Janet Byron arriti në gjuhësinë shqiptare me veprën Përzgjedhje ndërmjet alternativave në standardizimin e gjuhës: Selection among alternates in language standardization: The case of Albania, botuar më 1976.

Kjo gjuhëtare e ka meritën e veçantë në gjuhësi, sepse e para doli, duke i vënë në dukje problemet e politikës dhe të planifikimit gjuhësor të shqipes me një mbështetje të teorive gjuhësore, që në ato vite ishin më standardet. Kjo me mprehtësi i studioi të gjitha materialet e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, që u bind se normëzimi i gjuhës në Shqipëri konceptohej si propagandë, e cila i shërbente ideologjisë marksiste-leniniste. Ajo e ka mbështetur këtë vepër në ba-

zë të teorive gjuhësore tek gjuhëtarët: Rey, Haugen, Tauli, Fishman, Ferguson e të tjerë.

Shqipëria në vitet e shtatëdhjeta kishte arritur nivelin më të lartë të diktaturës, që kjo atmosferë shumë e zymtë dhe fort frikësuese e kishte mbyllur diskutimin mbi historinë e formimit të shqipes standarde pa ndonjë takim shkencor, ku do të diskutohej mbi bazën dialektore dhe zhvillimet e mundshme, që janë bërë brenda tyre. Kështu që gegërishtja u flak si një leckë dhe po të bënte dikush një fjalë të vetme në favor të saj, Kostallari dhe përkrahësit e tij do ta vlerësonin si antikombëtar dhe reaksionar. Ky qëndrim, thjesht e la gegërishten vetëm si variant të komunikimit familjar. Prandaj, Byron me argumente shkencore konkludon, se shqipja standarde është vetë dialekti toskë. Në këtë kumtesë, i kemi vënë në dukje pikëpamjet e kësaj gjuhëtare mbi bazën dialektore dhe qëndrimin zyrtar ndaj dialekteve të shqipes në planifikimin dhe normëzimin e saj. Siç shton ajo, kur e morën pushtetin, drejtuesit toskë e ngritën në një status më të lartë dialektin e tyre, duke mos i lënë asnjë mundësi inkuadrimit të gegërishtes brenda shqipes standarde.

21. James J. PENNINGTON, The Ohio State University: COASTAL CONVERGENCE: MONTENEGRIN IMPACT ON THE GRAMMAR OF ALBANIAN SPEAKERS IN ULCINJ/ULQIN.

22. Jani THOMAI, Tiranë: FJALORI ANGLISHT-SHQIP I LEONARD NEWMARK-UT

Fjalorët dygjuhësh kanë dy hapësira të mëdha: glosari në gjuhën e parë dhe identiteti leksiko-semantik me

gjuhën e dytë. Unë do të merrem me hapësirën e parë në fjalorin e Newmark-ut. Do të shoh çfarë shtresash leksikore janë pasqyruar në glosarin shqip të fjalorit, përpjesëtimi i tyre, duke i ndarë njësitë leksikografike në tri grupe sipas tipologjisë gjuhësore: njësi fjale, njësi nënfjale dhe njësi mbifjale. Në secilin grup do të ketë ndarje të brendshme sipas tipit të njësive, natyrisht duke i vlerësuar ato sipas kritereve leksikografike të zbatuara në fjalorin e dhënë, për të mbërritur te vlerësimi i përgjithshëm i fjalorit nga pikëpamja e tipologjisë leksikografike, e synimeve të autorit, e realitetit gjuhësor të shqipes etj.

23. Jonida XHYRA-ENTORF, München: SHKOKLITJE SOCIO-KULTURORE NË "OAED" HARTUAR NGA NEWMARK

Hartimi i një fjalori shoqërohet gjithmonë me prezantimin e një kulture. Fjalorët japin një përgjigje specifike dhe përmbajnë një funksion përkatës në sistemin arsimor dhe në dijen kolektive. Leksikografia shqipe-angleze jashtë Shqipërisë e Kosovës, përfaqësuar për një kohë të gjatë përmes An Historical Albanian-English Dictionary të vitit 1948 me hartues Stuart E. Mann, shënon një arritje të padiskutueshme me botimin gati një gjysmë shekulli më vonë të Oxford Albanian-English Dictionary nga Leonard Newmark. Një fjalor dygjuhësh sjell në lidhje të ndërsjelltë kodifikimet leksikore të dy gjuhëve të ndryshme në mënyrë që përdoruesi të prodhojë përgjegjëse të qarta e të njëkuptimshme, por pas të dhënave dhe informacioneve ravijëzohen gjithmonë arsyet e përzgjedhjes. Si përvijohet dimensioni sociokulturor i kësaj ndërmarrjeje madhore leksikografike duke pa-

sur parasysh tipologjinë, makrostrukturën dhe mikrostrukturën e saj, por gjithashtu edhe në këndvështrimi e dyfishtë të hartuesit e të recipientit si në gjuhën burimore, ashtu dhe në atë të synuar?

24. Julie KOLGJINI, Prishtinë: AESTHETIC DISRUPTIONS OF STANDARD LANGUAGE IDEOLOGY: THE CASE OF ALBANIAN

Throughout the past few decades standard language ideology and language choice, in particular in terms of spoken and written modes of communication, have been investigated extensively for numerous languages (e.g. British and American English). Few contemporary studies, however, have investigated the incurporation of alternative pools of linguistic resources and repertoires as found in the often stigmatized (sub)varieties of Albanian, including those in the literary works of the often-overlooked Albanian-American Miftar Spahija, as legitimate options. Paralleling the implementation of the hegemonic standard language ideology of Unified Literary Albanian, while also refusing to acquiesce to its fixed linguistic resources, Spahija (1990, 1998) embraces a trajectory that explores continuities across and within linguistic varieties. In doing so, he embarks upon a course similar to that of some of his predecessors and contemporaries, e.g. Ernest Koliqi (e.g. 2000, 2004) and Martin Camaj (e.g. 1994, 1996, 2001), among others. Spahija aesthetically interweaves linguistic hybridity, polycentrism, codemeshing, translanguaging, innovative coinages, and ludic components, among other linguistic mechanisms, within a fluid system, as is often ce-

lebrated in late and post-modern accounts of language usage practices. Rather than succumbing to restricting his linguistic resources to one rigid edifice, he pushes the boundaries of multiple systems, so as to capture the essence of linguistic agency – of the speaker, narrator, and author. Spahija's writings focus on the multivoicedness of the characters in his novels, refusing to limit them to the strict confines of the standard language culture of ULA. He does not conceal the alleged dysfluencies of katun(d)ar language practices (e. g. xhit, cf. çfarë, çka; tamël, cf. qumësht; kinxh, cf. kingj, qingj, qengj; dhami, cf. dhambi, dhëmbi; prâjshin, cf. pushonin; and lakmojshin, cf. lakmonin); rather, he endeavors to capture the intrinsic aesthetic in the heterogeneity of their usage. From the lens of critical discourse analysis, instead of composing a long treatise describing the inadequacies of the (current) standard, he provides readers with myriad examples of alternatives that surface in the author's (re)inventions of multiple linguistic histories (e.g. msojbanë, cf. msojtore, shkollë; dritore, cf. dritare, penxhere; bashkfshatas). Miftar Spahija's distinct approach is grounded in language practices in situ, thereby inviting the audience to play in his linguistic sandbox where they, too, can be active participants in authentic language usage practices, and where each reader's language repertoire is legitimate. Spahija's writings focus on the discourse of place, situated geo-semiotic linguistic landscapes, i.e. language emergent from contextualized situations. Through his novels (batrila) he offers an original interface between language and aesthetics, where stylized codecrossing and transidiomaticity are manifest.

25. Kastriot MARKU, Milano: NDIHMESA E ARSHI PIPËS NË STUDIMET LETRARE SHQIPTARE

Në veprimtarinë e shumëdisiplinare të Arshi Pipës, një vend me rëndësi zë edhe veprimtaria e tij studimore kushtuar letërsisë, posaçërisht letërsisë shqipe. Në kumtesën tonë ne jemi përqenduar kryesisht në serinë e tij trevëllimëshe "Trilogjia Albanica" (1978), "Albanian Folk Verse", "Hieronymos De Rada "dhe "Albanian Literature: Social Perspectives ", si dhe veprën tjetër të fundit të tij në këtë disiplinë botuar në vitin 1991, me titullin: "Contemporary Albanian Literature". Nisur nga mënyra e qasjes studimore që i bën letërsisë shqipe duke shqyrtuar vargun gojor si element substancial vetanak mbi të cilin u sindërtuan elementët bazikë të poetikës shqipe si nyjëtim me rëndësi në lidhje organike me poetikën evropiane, Arshi Pipa ka gjetur dhe zgjedhur veprën letrare të Jeronim De Radës si inkursion studimor për të bërë këtë në një mënyrë mjaft origjinale. Për të zgjeruar dhe kontekstualizuar fenomenet letrare si një përqasje e re jashtë modeleve dhe stereotipave studimore që aplikonin studimet letrare në Shqipëri, Arshi Pipa do të merrte përsipër një nismë tjetër atë të shqyrtimit të letërsisë bashkëkohore shqiptare, qoftë edhe si një sprovë kurajuese për të provuar mundësinë e historishkrimit të saj me të gjithë problematikën provokuese që ajo mbartte. Në këto katër studime shihet i profiluar qartë një studiues bashkëkohor serioz i letërsisë qoftë në planin metodologjik qoftë në atë praktik realizues, që shpërfaq gjithë elementët e duhur të një qasjeje tërësore rreth teksteve letrare me një përkuj-

desje atërore ndaj tyre. Në këtë këndvështrim Arshi Pipa përfaqëson një zë me rëndësi meritore në panoramën e studimeve tona letrare që meriton vëmendje dhe studime të mëtejshme.

26. Ke JING, Pekin: TJETRI NË VEPRËN E KADARESË: NJË QASJE KINO-AMERIKANË

Tjetri është një koncept i rëndësishëm në studimet e identitetit. Debati midis Kadaresë dhe Qosjes në vitin 2006 shkaktoi shumë diskutime lidhur me çështjen e identitetit kombëtar shqiptar, gjë që më shtyu të shkruaj disertacionin e doktoraturës mbi tjetrin e prezantuar në veprat e Kadaresë që nga vitet 60'. Disertacioni me titullin "Katër të tjerët në veprat e I. Kadaresë - Studim mbi identitetin kombëtar shqiptar", u shkrua për të pare se si tjetri për kombin shqiptar ka ndryshuar gjatë pesë shekujve të kaluar dhe se si ishin situatat përkatëse ndërkombëtare dhe vendore për nxjerrjen në pah të kategorisë së tjetrit, si perëndimor, lindor, fqinj, i brendshëm.

Vepra u krye kur autorja ishte studente në Universitetin e Lousville, SHBA. Leximet e shumta në gjuhën angleze dhe ndikimi nga udhëheqës amerikanë kanë lënë gjurmët e tyre në këtë punim disertacioni. Në të njëjtën kohë, si kineze, autorja e ka pothuaj të pamundur të shmanget nga ndikimet ideologjike të vendit të saj. Prandaj ky punim merr përsipër të ballafaqojë e të shqyrtojë ndikimet mbi autoren të pikëpamjeve të studiuesve perëndimorë si dhe të ideologjisë kineze. Me fjalë të tjera, ky punim analizon me fakte qasjen kino-amerikane të disertacionit të kryer para dy vjetësh, si kritikë dhe autokritikë e veprës së autores.

27. Kolec TOPALLI, Tiranë: PËR NJË SHTRESIM KRONOLOGJIK-ETIMOLOGJIK TË LEKSIKUT FETAR NË POEZITË E NOLIT

1) Leksiku biblik i poezive të Nolit dhe shtresimi i tij;
2) Shtresa autoktone e trashëguar nga fondi indoeuropian;
3) Huazimet e vjetra nga latinishtja;
4) Huazimet italiane;
5) Huazimet nga greqishtja e mesme dhe e re;
6) Huazimet turke;
7) Huazimet moderne.

Fjalët kyçe: leksik, biblik, huazim, shtresë

28. Kujtim SHALA, Prishtinë: NOLI: HISTORIA..., REVOLUCIONI... E AUTOBIOGRAFIA

Historia..., *Revolucioni...* e *Autobiografia* janë vepra diskursive e dëshmuese, të cilat e provojnë Fan S. Nolin dijetar e rrëfimtar, diskursin e motivuar të tij, pra Nolin *shkrimtar*.

Historia... rrëfen e provon Heroin nacional të shqiptarëve, *Revolucioni...* - modelin social që zgjedh Noli, ndërsa *Autobiografia* lidh në një vend jetën e veprën e Nolit si rrëfim e dëshmi.

Skënderbeu është figura që do t'i ngjajë Noli në jetën nacionale, revolucionin e provoi vetë, Autobiografia zbulon edhe figurat e tjera të identifikimit të Nolit, Krishtin - hero moral e Napolonin - hero militant.

Diskursi i *Historisë...* do diskursivitet e prova, ai i *Revolucionit...* - projeksion social, ndërsa diskursi i *Autobiografisë* personin Fan Noli e bën *informator* e *personazh*.

I lexuar në këto vepra, Noli hapet në faqet e argumentimeve të rralla, të ideologjisë, projeksioneve e të dëshmive personale.

Këto vepra e provojnë dijetarin e stilistin e zgjedhur të shqipes, retorin që njeh fuqinë e argumentit e të mesazhit, *autorin* që shkruan me *marrësin* përballë, pra *autorin* që përherë shkruan me një tendencë retorike (bindëse).

Të shkruara e të botuara në kohë të ndryshme të jetës së autorit, këto vepra provojnë konstanta të diskursit të Nolit dhe lidhin rrjetin ideve të tij në një ideologji të rrëfyer e të provuar.

29. Ledi SHAMKU-SHKRELI, TIRANË: KONTRIBUTI I JANET BYRON

30. Lindita SEJDIU-RUGOVA, Prishtinë: KUNDËRVËNIET ASPEKTORE BRENDA SHQIPES NË STUDIMET E FRIEDMAN-IT DHE NË STUDIMET E SOTME TË SHQIPES

Gramatikat e shqipes në përgjithësi i kushtojnë pak ose aspak hapësirë aspektit si kategori gramatikore. Në gramatikën e ASHRSH-së, aspekti nuk përcaktohet si kategori foljore më vete, por flitet për "forma gramatikore foljore që, përpos kuptimeve kohore, shprehin edhe ngjyrime të ndryshme aspektore" (Gramatika I, 1995: 274). Po aty, thuhet se dallimet midis të së pakryerës, të së kryerës së thjeshtë dhe të së kryerës kanë më fort karakter aspektor varësisht nga mënyra e paraqitjes së veprimit : si të përfunduar, si të papërfunduar ose si veprim në zhvillim e sipër në një çast të së shkuarës (Gramatika I, 1995: 274) .

Victor Friedman është një nga albanologët e rrallë që ndalet dhe e studion më detajisht këtë kategori. Ai në punimin e tij të botuar në vëllimin "Studies on Albanian and other Balkan Languages" (2004:291), i krahason disa tipare aspektore të shqipes në raport me bullgarishten dhe turqishten dhe arrin në përfundim se shqipja, ndryshe nga bullgarishtja dhe turqishtja, e zgjedh të kryerën (aoristin) në një strukturë të varur që shpreh sekuencë ose fillim të një veprimi dhe gjatë përkthimit nga gjuhët tjera në shqipen, aoristi përshtatet mirë me çfarëdo gjuhe që përdor aorist. Ky punim është një nga punimet e pakta të kësaj periudhe që merret me studimin e aspektit të shqipes qoftë edhe në këndvështrim krahasimtar, me atë të gjuhëve tjera ballkanike.

Në studimet e sotme, aspekti si kategori gramatikore, ndërkaq, lidhet ngushtë me qëndrimin folës dhe me mënyrën se si folësi e sheh apo e paraqet situatën e komunikimit nga aspekti kohor (këtu termi kohë ka të bëjë me kohën si temp a rrjedhë veprimi, jo si kohë foljore) - pra, mënyra se si veprimi i shprehur nga folja konsiderohet ose përjetohet në raport me kohën si koncept universal (Quirk et al, 2002: 188). Po qe se e shohim nga brenda aspektit kohor, kemi të bëjmë me aspektin progresiv (të vazhdueshëm), ndërkaq nëse e kundrojmë si një proces kohor, ku ajo si emetuese nuk mund të ndërhyjë në rrjedhën e atij procesi, atëherë kemi të bëjmë me aspektin joprogresiv.

Në terma të Huddleston-it, interpretimi i kategorisë së kohës, të mënyrës dhe të aspektit në një gjuhë do të duhej të interpretoheshin varësisht nga lloji i situatës së komunikimit të shprehur në një fjali të caktuar të asaj gjuhe (Huddlestone 2002:118). E kjo si-

tuatë mund të jetë statike ose dinamike. Kështu, duke u mbështetur në terma të tillë, në shqipen mund të flasim për situata të komunikimit që shprehin gjendje: Ata besojnë në Zot! Më pëlqen! Flamuri i Shqipërisë është i kuq! ose për një situatë dinamike që shpreh një proces aktiviteti: Ne po luajmë futboll. Unë ia lexoja përrallën Gresës. Eca gjatë në plazh. Një situatë të caktuar mund ta interpretojmë si telike (situatë e kryer, me një pikë përfundimi) që i përmbledh arritjet tona: Erdha këmbë deri në shtëpi. Ajo e shkroi librin. Erdha këmbë në shtëpi. (Eca deri në shtëpi) ose si një situatë që nxjerr në pah arritjet tona gjatë një procesi: E gjeta portofolin! (isha duke e kërkuar), Po e mbyll këtë seancë… (ishim duke diskutuar) etj.

Këto situata nganjëherë mund të dalin të kombinuara dhe shpesh janë treguesit kohorë që e bëjnë dallimin dhe na mundësojnë një interpretim të saktë. Kështu fjalia: Unë i bëra 5 km atë ditë. do të mund të interpretohej edhe si situatë që shpreh një aktivitet në një rast të caktuar, por mund të implikojë dhe idenë "unë e kisha zakon të ecja vazhdimisht çdo ditë".

Të gjitha këto situata kuptimore të aspektit na çojnë drejt aspektualitetit si kategori semantike, e cila mund të kategorizohet në dy kategori themelore: aspekti i kryer dhe jo i kryer. Shqipja ka shënjues gramatikorë të këtij kategorizimi dhe ndër më themelorët janë mbaresat vetore të së pakryerës dhe të së kryerës së dëftores: puno-ja (imperfekti) dhe kam punuar (perfekti) kundruall mbaresës së të kryerës së thjeshtë: punova (aoristi). Pra, shqipja, ngjashëm me disa gjuhë indoevropiane, e ka ruajtur sistemin tre-termësh, si pasojë e dallimit binar aspektor: perfektiv/ joperfektiv dhe durativ/ jodurativ.

Lyons-i (1968:315) e konsideron aspektin shpërndarje në kohë, ndryshe nga koha foljore që paraqet vend-ndodhje në kohë. Sipas tij, aspekti, ndryshe nga koha foljore, nuk është koncept deiktik, pra nuk kundrohet në raport me momentin kohor të të thënit.

Megjithatë, situatat e ndryshme të komunikimit na dalin shpesh të shumëkuptimshme edhe brenda vetë trajtës së caktuar aspektore. Po qe se i analizojmë fjalitë: a) Punoja në fabrikë dhe b) Po punoja me zell dallimi aspektor nuk është i dukshëm, derisa nuk e klasifikojmë situatën e tillë të komunikimit si gjendje (isha i punësuar në fabrikë atëbotë) dhe si aktivitet a proces dinamik (punoja me zell-akti i të punuarit).

Këtë dallim brenda aspektit jo të kryer të shqipes e që në të vërtetë shpreh një gjendje të papërfunduar a iteracion të shqipes (punoja) në raport me aoristin, i cili shpreh situata të vetme të përfunduara ose të një-pasnjëshme e të kufizuara nga aspekti kohor (punova), Breu (2010:451) e sheh si reduktim të imperfektit të thjeshtë, meqë, sipas tij, po zëvendësohet vazhdimisht me struktura perifrazuese me këtë funksion (isha duke punuar, jam duke punuar). Do theksuar se Breu (2010:451) brenda një dallimi të tillë aspektor e fut edhe dallimin brenda progresivitetit të së tashmes (po punoj / jam duke punuar). Rrjedhimisht, Breu mendon se dallimi i mirëfilltë aspektor aorist/ imperfekt po zbehet, duke i lënë vend dallimit e tashme (punoj)/ e kryer (kam punuar) si dhe raportit aspektor të së shkuarës: e pakryer (punoja)/e kryer e tejshkuar (pata punuar).

31. Mario DE MATTEIS, Bochum: DAS INTEGRIERTE FREMDSPRACHEN- UND SACHFACHLERNEN - AUCH EIN MODELL FÜR DAS KOSOVARISCHE SCHULWESEN AUF DEM WEG NACH EUROPA?

Im letzten Jahrzehnt hat sich im englischen, französischen und italienischen Sprachraum ein Begriff durchgesetzt, der in immer stärkerem Maße zur Bezeichnung des Konzeptes verwendet wird: Content and Language Integrated Learning (abgekürzt: CLIL) bzw. Enseignement d'une Matière par l'Integration d'une Langue Etrangère (abgekürzt EMILE auf Französisch und EMILS auf Italienisch). Zwar wird im deutschsprachigen Raum weiterhin offiziell der Begriff Bilingualer Sachfachunterricht verwendet, jedoch finden sich inzwischen auch Versuche, den englischen Begriff CLIL sinngemäß ins Deutsche zu übertragen (z.B. Integriertes Fremdsprachen- und Sachfachlernen). Dabei wird betont, dass in einer CLIL-Schule – wie im albanisch-deutschen Pilot-Programm des albanischen Gymnasium Sami Frasheri in Tirana – das vor sieben Jahren gestartet wurde – nicht der gesamte Unterricht, sondern nur der Fachunterricht in einer beschränkten Anzahl von Fächern in der Fremdsprache durchgeführt wird.

In Tirana wird der CLIL-Unterricht zum einen von einem normalen – zum Teil erweiterten – fachlich kompetenten Fremdsprachenunterricht begleitet, zum anderen findet im CLIL-Unterricht selbst auch Sprachunterricht statt, insbesondere wenn es die Vermittlung des Sachfachs (z.B. Mathematik oder Physik) erforderlich macht. Das bedeutet also, dass der CLIL-Unterricht wirklich ein integrierter Sprach- und Sachfachunterricht ist.

Eine Erweiterung der Sachfachfächer auf z.B.: Geschichte, Geographie, Sozialwissenschaften (mit spez. Ausrittung in politischer Bildung (educazione civica, civic education)) etc. könnte nicht nur die Desiderata der EU erfüllen, sie könnte vielmehr ungeahnte Möglichkeiten in der universitären Ausbildung wie in den beruflichen Einsatz von Universitätsabsolventen in schulischen oder Verwaltungseinrichtungen Albaniens, auf dem Weg nach Europa.

Schlüsselwörter: CLIL, EMILE, EMILS, Bilingualer Sachfachunterricht, CLIL-Unterricht

32. Mehmet HALIMI, Prishtinë: FUNKSIONI SEMANTIK E ARTISTIK I KOMPOZITAVE NË VEPRIMTARINË LETRARE TË NOLIT

Ndonëse edhe nga gjuhëtarë e albanologë të huaj, shqipja është konsideruar si e varfër me kompozita, megjithatë, Fan Noli në veprimtarinë e vet letrare ka dëshmuar se ajo është mjaft e pasur. Ai, jo vetëm i ka përdor ato në funksion semantik dhe artistik, por edhe ka krijuar kompozita të reja, të cilat nuk janë përdorur para tij.

Gjuha ka mjete të shumta dhe mundësi të gjera për të shprehur shkrimtari mendimet e veta. E këto veçori të gjuhës së vet amtare, Noli i shfrytëzoi racionalisht. Njëra nga këto veçori semantike dhe artistike për të shprehur më me veçanti nocionet kuptimore janë edhe kompozitat, që përdori Fan Noli, në veprimtarinë e vet letrare dhe në përkthimet për të cilat do të bëjmë fjalë në kumtesën tonë të zgjeruar.

Tipat në fushën e fjalëformimit dhe përdorimi i tyre në veprimtarinë letrare të Nolit, janë të nduarnduart,

por ne do të veçojmë vetëm fjalëformimin kompozitor, duke marrë në shqyrtim efektet gjuhësore dhe funksionin semantik e artistik të tyre në vargun nolian, por edhe në përkthime. Noli, vargjet e tij poetike i përdorë me një shije të hollë artistike, dashuri e intimitet njerëzor me plot respekt e ndjenjë shoqërore, qoftë ndaj subjekteve apo objekteve të personifikuara ai arriti t' i shpreh me veçanti të rrallë gjuhësore, poetike, semantike e artistike, me anë të fjalëformimit kompozitor. Fjala është mjeti shprehës i poetit. Shkrimtarët e poetët duke shkruar gjuhën e tyre, shumë fjalë e tipa fjalësh i bëjnë të përdorshme e kuptimplote, i bëjnë të rëndomta e të natyrshme për gjuhën tonë letrare, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër e përpunojnë, e përsosin, e përkryejnë dhe e latojnë atë me shprehje të reja, e pasurojnë me fjalë e tipa fjalësh të reja e të panjohura deri më atëherë, duke na ofruar mundësi të gjera në shprehjen e mendimeve e ndjenjave tona. Këtë cilësi e mjeshtri të përdorimit dhe të kultivimit të veçantisë gjuhësore e posedoi dhe Noli në shkrimet e veta. Prandaj, ndër të tjera edhe për këtë vlerë të këndimit të gjuhës meriton respekt të veçantë, sepse "Fan Noli si për formimin poetik si për shprehjen gjuhësore qëndron më vete në literaturën shqiptare" – shprehet E. Çabej.

33. Mehmet KRAJA, Prishtinë: ËNDRRA AMERIKANE E SHQIPTARËVE. (NJË VËSHTRIM HISTORIK DHE POLITIK MBI DIASPORËN SHQIPTARE NË AMERIKË)

Historia e diasporës shqiptare në Amerikë, e shkruar dhe e publikuar deri më tani, është tërë-

sisht nacional-romantike. Historia e Federatës Panshqiptare "Vatra", historia e gazetës "Dielli", si dhe biografitë e dy figurave më të rëndësishme të kësaj diaspore, Konica dhe Noli, janë shkrime idealizuese, me mungesa të theksuara të objektivitetit dhe të analizës kritike. Janë dy "periudha të arta" të diasporës shqiptare në Amerikë, që lidhen me situatat kritike të atdheut të tyre: periudha deri më 1920, gjatë bërjes së Shqipërisë dhe në kohën kur ajo rrezikonte të zhbëhej, dhe periudha e krizës së Kosovës. Koha ndërmjet këtyre dy periudhave është e mbushur me përçarje, me zënka politike, me grindje, të ndikuara nga ama e kësaj diaspore, nga Shqipëria dhe së fundi edhe nga Kosova. Historinë e "lavdishme", gati 100-vjeçare, të këtyre zënkave politike e kanë filluar Noli dhe Konica.

34. Mimoza PRIKU, Shkodër: FUQIA E FJALËS NË FJALOR: FJALËSI SHQIP NË FJALORIN SHQIP-ANGLISHT TË LEONARD NEWMARK-UT

Objekt studimi në këtë punim është bërë fjalësi shqip i fjalorit Oxford Albanian – English dictionary (Tiranë, 2000) të albanologut Leonard Newmark, si një pjesë e rëndësishme e traditës së studimeve albanologjike të krijuar e të kristalizuar tashmë në Amerikë. Natyrisht në hedhjen e këtyre themeleve një rol të rëndësishëm kanë luajtur një grup intelektualësh të njohur shqiptarë, të cilët, me mjaft vështirësi, nisën të botonin edhe disa periodikë që trajtonin probleme të ndryshme me karakter albanologjik, si "Kombi", "Dielli", revista "Albania". Kështu nisi dhe u zgjua interesi i studiuesve amerikanë për shqipen dhe albanolo-

gjinë, interes i cili u finalizua me studime serioze me punën e palodhur të gjuhëtarëve E. P. Hamp, L. Newmark, G. L. Bevington, V. Friedman, J. Brian etj.

Në këtë punim do të përpiqemi të analizojmë disa prej vlerave dhe risive të fjalorit shqip-anglisht të hartuar nga Leonard Newmark, i cili pati një truall të begatë dhe një traditë të fjalorëve dygjuhësh. Leksikografia shqipe zë fill në fakt me një fjalor dygjuhësh latinisht-shqip, Fjalorin" Dictionarum latino-epiroticum" të Frang Bardhit të botuar më 1635. Për të vazhduar me F. M. Da Leccen "Dizionario italiano-albanese" (1702) dhe një sërë fjalorësh shqip-italisht apo shqip-latinisht. Më pas K. Kristoforidhi botoi në Athinë një "Fjalor të gjuhës shqipe" në vitin 1904, ndërsa anëtarët e Shoqërisë Bashkimi përpiluan një tjetër fjalor dygjuhësh (1908). Ndër të parët fjalorë anglisht-shqip është "English- Albanian dictionary" përpiluar nga Dennis J. Kambury (Boston, 1918), i ndjekur nga një shqiptar, Kostë Çekrezi, i cili më 1923 botoi në tjetër fjalor anglisht-shqip.

Megjithë këtë trashëgimi leksikografike, L. Newmark nga njëra anë, ka arritur ta shfrytëzojë dhe të mbështetet tek ajo, por, nga ana tjetër, ka ditur të sjellë mjaft risi, si në fjalësin ashtu edhe mënyrën e organizimit. Hartuesi i këtij fjalori është përpjekur që të plotësojë nevojat e përdoruesve të tij jo vetëm në standardin e shqipes, por disa varietete të saj, duke ndjekur traditën amerikane të hartimit të fjalorëve. Ai thyen traditën shqiptare edhe në mënyrën e organizimit të këtij fjalësi, i cili bazohet në ndarje morfematike të fjalës.

Pas një analize të këtij fjalësi, i cili duhet të vlerësohet për ripërtëritjen e mjaft fjalëve të shqipes që kishin mbetur të harruara, mendojmë se hartimi i një fjalori të këtillë, me një model të ri, është ndër përpjekjet e para për një fjalor thesarus të shqipes.

Fjalë kyçe: fjalës, albanologji, fjalor dygjuhësh, thesarus

35. Muhamet HAMITI, Prishtinë: LETËRSIA SHQIPE DHE PERSPEKTIVA E A. PIPËS

Shkrimtar e kritik, Arshi Pipa ka lënë një trashëgimi të vlefshme në albanistikë me studimet e tij botuar përmbledhtas në anglishte në vitin 1978 me titullin e përbashkët "Trilogia Albanica" (përkthyer e botuar në shqip këto vitet e mbrama) si dhe në studime të tjera të veçanta, si ai për politikat gjuhësore në Shqipërinë e Hoxhës.

Duke i parë studimet e tij veç e veç dhe në tërësi, por edhe përballë dijes letrare të kohës në Shqipëri e Kosovës, kumtesa mëton të nxjerrë idenë e letërsisë shqipe nga këndvështrimi i Arshi Pipës, të krijuesit, dashuruesit dhe kritikut të kësaj letërsie. Me dashurinë e lindur e të kultivuar, me sovranitetin dhe distancën që i krijonte si arsimimi e dija e nxënë jashtë, ashtu edhe jeta në mërgim, Pipa afirmoi perspektivën e vet, krijoi hartën letrare shqiptare në vija të trasha, pa pasur për të gjallë ndërkomunikimin normal me kolegët e vet të dijes në atdhe dhe me lexuesit në botën shqiptare.

Fjalë kyçe: letërsia shqipe, harta letrare, kritika, mërgimi, perspektiva

36. Rexhep ISMAJLI, Prishtinë: STUDIMET ALBANISTIKE NË AMERIKË

Interesimet për gjuhën, kulturën dhe historinë shqiptare në SHBA janë mjaft të hershme, edhe pse më të vona se në vendet europiane. Ato u nxitën nga fundi i sh. 19 dhe fillimi i sh. 20 dhe me vendosjen dhe forcimin e komunitetit shqiptar në Amerikë. Pjesa e dytë e sh. 20 ishte koha kur këto studime morën impulse të reja.

Studimet albanistike në SHBA kanë dhënë një ndihmesë me vlerë për njohjen e botës shqiptare, e kanë begatuar dijen dhe e kanë ushqyer miqësinë midis dy popujve. Albanistët amerikanë kanë shtruar çështje themelore në studimet gjuhësore shqiptare. Interesimet e mjediseve të ndryshme amerikane për nxënien e gjuhës shqipe kanë sjellë si rezultat manuale të vlefshme në këtë drejtim. Përvoja e madhe në përshkrimin e gjuhëve, teknikat dhe metodat e zhvilluara për hulumtimin në terren, kanë bërë që ata të jepnin vepra me peshë, si përshkrimet e Eric P. Hamp, të Leonard Newmark, të Gary L. Bevington për fonologjinë gjenerative të shqipes, të Victor Friedman-it për morfosintaksën, të Joseph Brian-it për infinitivin të parë dhe në kontekst ballkanik, të Janet Byron për standardizimin e shqipes, e të më të rinjve në fusha të ndryshme. Duke qenë studimet krahasimtare në SHBA dukshëm më të avancuara, sidomos në gjysmën e dytë të sh. 20, këta studiues kanë bërë që edhe për shqipen të kemi rezultate të shquara, si ato të Hamp-it, i cili paraqet një nga kulmet e gjuhësisë së krahasuar në botën e sotme. Kjo ka bërë që edhe në fushën e studimeve etimologjike atje të bëhen përpjekje serioze, e kjo domethënë edhe në fushë të historisë së brendshme të gjuhës. Do përmendur këtu, përveç Hamp-it, edhe Martin Huld me etimologjitë e tij. Në stu-

dimet ballkanistike dijetarët amerikanë po bëhen gjithnjë e më shumë prijës. Shqipja në këtë aspekt zë një vend qendror dhe aportet e Hamp-it, të Friedman-it, të Brian-it, të Kazazis-it, etj. Në fushën e mësimdhënies së shqipes e të fjalorëve rezultatet kanë qenë jo të vogla: nga hartimi i Gramatikës së referimit e deri te Fjalori i tipit Oxford i L. Newmark-ut. Në albanistikën amerikane ka pasur depërtime serioze në zbatimin e parimeve dhe të metodave të sociolinguistikës, po ashtu, por kanë munguar, pos në fonologji, zbatimet e të arriturave serioze të gjuhësisë dominante amerikane të 40 vjetëve të fundit – të metodave gjenerative-transfromacionale, në fushën e shqipes. Kjo mund të ketë arsye të ndryshme, ndër të cilat komunikimi ynë i një niveli të ulët me to mund të jetë e rëndësishme. Gjithsesi mungesa e një qendre të institucionalizuar studimore për shqipen në nivele të njësisë së pavarur akademike ka lënë pasoja serioze në këtë drejtim.

Këto studime në përgjithësi janë rezultat jo vetëm i kërshërisë shkencore, po motivohen nga miqësia dhe dashuria e këtyre studiuesve ndaj shqiptarëve si popull në tërësi. Kontaktet, gjendja e vështirë e Kosovës dhe e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, kanë luajtur një rol me peshë po ashtu.

Gjithandej figurë qendrore na del Eric Pratt Hamp, i cili sivjet mbush 95 vjet dhe edhe kjo konferencë reflekton frymën e celebrimit të kësaj figure madhore të linguistikës amerikane, në veçanti të albanistikës së saj.

37. Rusana BEJLERI, Sofje: KONTRIBUTI UNIK I ALBANOLOGUT KANADEZ ROBERT ELSIE NË BOTË

Në qershor të këtij viti albanologu kanadez Robert Elsie mbush 65 vjeç. Vetë statistika prej kohësh, ende pa arritur në këtë jubile, e ka caktuar si popullarizuesi i

huaj më prolifik i kulturës shqiptare deri tani. Robert Elsie zë një pozitë unike në botën e sotme globale për shkak të kombinimit të dy faktorëve: interesimit konstant të thellë pedantik shkencor në fushën e albanologjisë dhe mjeshtërisë së zotërimit të anglishtes amtare. Po të mendojmë për këta faktorë veç e veç, asnjëri nuk përbën ndonjë risi, madje i dyti pranohet automatikisht si i mirëqenë. Por anglishtja e Robert Elsies nuk është një anglishte e zakonshme as në përkthimet letrare, as në punimet dhe përkthimet shkencore. Dhe pikërisht fokusi i kësaj konference të AShAK-ut është tribuna e përshtatshme që t'i kushtohet vëmendje teksteve të Robert Elsies për meritën e tyre gjuhësore, për faktin se përbëjnë mënyrë shprehjeje për të shijuar dhe vlerësuar më vete.

Në këtë kumtesë do të shqyrtohet vlefta linguistike të punimeve të Robert Elsies dhe rëndësia e saj për albanologjinë.

38. Rrahman PAÇARIZI, Prishtinë: GRAMATIKA E shqipes e Leonard NEWMARK-UT

"Shqipja standard – një gramatikë referente për studentët" e autorit Leonard Newmark, në bashkëpunim me Philip Hubbard dhe Peter Prifti, është një libër i rëndësishëm për gramatikën e shqipes. Që në fillim të librit, Newmark thotë se ky nuk është një libër linguistik a ndonjë studim shkencor i veçantë. Ai thotë se në një masë të madhe ky libër është përshtatje e librit "Gramatika e Gjuhës Shqipe" nga një grup autorësh, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë e vitit 1976.

Mirëpo, në të vërtetë, libri i Newmarkut është ndërtuar krejt ndryshe, duke ndjekur vetëm shembujt dhe shpjegimet nga libri i përmendur. Kështu, Newmark ka ndjekur një model strukturalist të shpjegimit të problematikës dhe ka përdorur një terminologji më të avancuar sesa libri në të cilin thotë se është mbështetur. Newmark e nis gramatikën e tij me fonetikën e shqipes aktuale, ndërkaq gramatikën nuk e ndan në morfologji e sintaksë, por e trajton si morfosintaksë, duke u marrë me problematikat një nga një.

Punimi trajton edhe recensionet e shkruara mbi këtë libër nga autorë si Fiedler, Hamp etj., duke u ndalur sidomos në vlerësimet që Eric Hamp i bën studimit të gramatikës strukturale të shqipes nga L. Newmark.

39. Sabri HAMITI, Prishtinë: UJDHESA E SHPËTIMIT

Në kumtesën "Ujdhesa e shpëtimit" trajtohet letërsia shqipe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në shekullin XX, duke u përqendruar tek autorët Faik Konica, Fan S. Noli, Arshi Pipa dhe Bilal Xhaferri, që u përkasin brezave të ndryshëm të letërsisë shqipe. Trajtohet në mënyrë të veçantë letërsia e tyre, para se të mbërrijnë në Amerikë dhe letërsia e tyre e shkruar në Amerikë; duke analizuar raportin ndërmjet modelit kritik kulturor që specifikohet si shkrim kritik shoqëror dhe shkrim kritik letrar. Të gjithë këta autorë i lidh një fat i përbashkët ta mbarojnë jetën në Amerikë dhe që letërsia e tyre e krijuar dhe e botuar atje të jetë më fort letërsi kritike (riprodhuese) se sa letërsi krijuese. Ky fenomen letrar, që përfshin individë e biografi të ndryshme është parë i kushtëzuar nga konteksti shoqëror dhe konteksti letrar në Shqipëri e në Amerikë.

40. Seit MANSAKU, Tiranë: PROBLEME TË PASKAJORES SË SHQIPES NË KONTEKSTIN E GJUHËSISË BALLKANIKE SIPAS VEPRËS SË STUDIUESIT BRIAN D. JOSEPH

Në këte kumtesë diskutohen aspektet e ndryshme të paskajores së shqipes në kontekstin ballkanik. Pas shqyrtimit të ndihmesave të shumta të Brian Joseph në veprën e tij për paskajoren, autori merret me shqyrtimin e konstatimeve lidhur me çështjen e zhdukjes së paskajores në gjuhët ballkanike në raport me shqipen, ku mendon se mund të argumentohet kundër zhdukjes në tërësinë e saj. Kumtesa merret dhe me aspekte të tjera të çështjes së paskajores.

41. Shaban SINANI, Tiranë: ALBANIAN CATHOLIC BULLETIN, NJË DRITARE NDIHMESASH NË SHKENCAT KOMBËTARE NDËR DIJETARËT SHQIPTARO-AMERIKANË

Albanian Catholic Bulletin është një prej tribunave shkencore-kulturore shqiptaro-amerikane gati krejt në mënjanësi të studimeve të sotme shqiptare, që, për rreth një dekadë e gjysmë (1980-1994), në 15 vëllimet e veta, me afro 2200 faqe, paraqiti pikëpamjen dhe rezultatet e kërkimeve të intelektualëve shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të miqve të tyre albanologë në SHBA për çështje të burimit etnik, fatit historik, traditës gojore dhe trashëgimisë letrare e diturore të shqiptarëve në gjithë hapësirën e tyre historike ballkanike dhe kudo nëpër botë.

Bulletin-i u botua për 12 vjet prej The Albanian Catholic Information Center me qendër në San Francisco të shtetit të California-s dhe më pas, që nga vëllimi XIII (1992), nga The Albanian Catholic Institute. Kryere-

daktor i saj qe gjatë gjithë kohës Gjon Sinishta († 1995). Redaksia e Bulletin-it qysh në themelim ishte ndërshqiptare, ndërkishtare, ndërfetare e ndërkombëtare.

Bulletin-i pati si qëllim përparësor shpalljen e historisë së persekucionit të klerit katolik në Shqipëri; të interesimit të Selisë së Shenjtë dhe të kishave motra për bashkësinë e krishterë ndër shqiptarët; të lidhjeve historike-kulturore dhe të kontributeve të tyre ndaj Krishterimit si religjion, mënyrë të menduari, qytetërim e kulturë ndër shekuj; të raporteve ndërkishtare në botën shqiptare. Pavarësisht këtyre përparësive, Bulletin-i ruajti vijimësisht karakterin e vet laik-shekullar, duke qendruar kështu me profilin e saj përkrah Shêjzave, por me një raport deri-diku të zhdrejtë dhe të drejtkuptuar midis albanologjisë e historisë së Krishterimit në Shqipëri.

Kjo revistë ribashkoi mendimtarët shqiptarë në SHBA e në Europë, pavarësisht besimit të tyre, nga Martin Camaj te Namik Ressuli; si dhe dashamirësit e shqiptarëve, sidomos nga shteti i Kalifornisë, si Stephen Schwartz, një prej bashkëpunëtorëve të rregullt të saj dhe njëherësh urë ndërveprimi me San Diego Jewish World.

Kritike ndaj zhvillimeve politike dhe ideologjike në Shqipërinë shtetërore, ajo ndoqi me shumë simpati dhe ofroi informacion e interpretime të besueshme për zhvillimet e reja në Kosovë që nga viti 1981; plotësoi boshësinë që linin shkencat albanologjike ndaj një pjese të letërsisë dhe të dijes që ishin shpallur jashtë objektit të tyre (ndaj letërsisë dhe dijeve të ndaluara); u ofroi hapësirë e nderim atyre albanologëve të huaj, sidomos amerikanë, por dhe të tjerë, që ishin shpallur

të padëshiruar në Shqipëri; u ofroi vëmendje ngulimeve të hershme shqiptare, arbëreshëve dhe arvanitëve, por dhe ngulimeve më të vogla e më të vonshme, thuajse jashtë qëllimeve të albanologjisë zyrtare; ndoqi me vëmendje jetën letrare dhe shkencore në gjithë hapësirën shqiptare dhe ua bëri të njohur atë botës shqiptaro-amerikane dhe lexuesit të huaj, duke mbajtur në funksion urat e domosdoshme të ndërkomunikimit midis dy botësh të ndara; mori pjesë në debatet themelore për letërsinë shqipe të realizmit socialist duke përfshirë ato për veprën e I. Kadaresë, M. Camajt dhe shkrimtarët e periudhës ndërmjet dy luftërave (Fishta, Koliqi, Konica, Kuteli, Poradeci, Maloki). Buletini Katolik Shqiptar deri në vitin 1990 doli vetëm në gjuhën angleze, kurse në pesë vitet e fundme pati dhe shkrime të shkurtra shqip.

Koleksioni i kësaj reviste është me rëndësi për njohjen e veprimtarisë intelektuale shqiptare në SHBA, sidomos të shqiptarëve të Malit të Zi dhe të atyre që u bashkuan me ta për simpati apo për ideal shkencor. Ai është një enciklopedi e vogël e përurimit të një numri të konsiderueshëm shkrimtarësh e studiuesish shqiptarë, që janë shfaqur kryesisht ose vetëm përmes tij. Ky koleksion herët a vonë do të jetë e nevojshme t'i bashkohet bibliotekës albanologjike dhe të integrohet në studimet shqiptare.

42. Shkumbin MUNISHI, Prishtinë: PIKËPAMJET PËR SHQIPEN STANDARDE TË ZHVILLUARA NË SHBA

Në këtë punim do të trajtohen pikëpamjet kryesore lidhur me shqipen standarde dhe rrugët që janë ndjekur për normimin e saj, të cilat janë zhvilluar në Shte-

tet e Bashkuara të Amerikës. Brenda këtij kuadri, do të merren në shqyrtim pikëpamjet e dy autorëve, Jannet Byron dhe Arshi Pipa, të cilët kanë vepruar në Shtetet e Bashkuara. Pra do të bëhet një krahasim i pikëpamjeve dhe qasjes që kanë pasur këta dy autorë lidhur me shqipen standarde dhe procesin e standardizimit të shqipes në përgjithësi. Qëllimi parësor është që të krahasohen, në njërën anë, pikëpamjet e një autoreje amerikane dhe argumentimet që mbështesin tezat e saja për standardizimin e shqipes, dhe, në anën tjetër, pikëpamjet e një autori shqiptar disident që ka jetuar dhe vepruar në SHBA. Përmes kësaj paraqitjeje synohet të dallohen pikënisjet nga të cilat janë nisur këta dy autorë për ta përshkruar standardizimin e shqipes.

43. Shpend BENGU, Tiranë: KONTRIBUTI I SHBA-SË NË DOKUMENTIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE

Në këtë kumtesë do të paraqiten disa dokumente nga ekspeditat e ndryshme, të organizuara nga studiuesit amerikanë, në fillimet e shek. XX.

Ekspedita e parë amerikane në Shqipëri u drejtua nga Prof. Elmer E. Jones i Northwestern University Evanston. Ata u nisën nga New York-u, më 2 qershor dhe arritën në Shqipëri, më 11 korrik të vitit 1923.

Qëllimet e kësaj ekspedite, dhe i të tjerave që u zhvilluan gjatë fillimit të shek. XX, ishin të shumta, ku ndër më kryesoret për organizatorët ishin bashkëpunimi i SHBA-së me Shqipërinë, në fushat e edukimit, tregtisë, agrikulturës, financës dhe religjionit, për ta interuar Shqipërinë me vendet e tjera të Ballkanit.

Duke analizuar dokumentacionin e ekspeditave amerikane të realizuara në fillimet e shek. XX, vihet re se materiali më i madh i përket studimit dhe dokumenttimit të trashëgimisë jomateriale shqiptare, e parë kryesisht në këndvështrimin antropologjik.

Prej disa vitesh vazhdon kërkimi i disa materialeve arkivore ku ndër të cilët më i rëndësishmi është regjistrimi filmik i ekspeditës së dytë amerikane në Shqipëri, në maj të vitit 1928, me titull "A journey through Albania" me Movie Camera. Filmimet janë realizuar në 2 bobina janë shfaqur për herë të parë nga Faik Konica, më 28 korrik të vitit 1928, në Malta Hall të Ohio- s dhe më 28 nëntor të vitit 1928 në Tremont Temple të Bostonit, me rastin e Festës së Pavarësisë. Deri më sot ky material ende nuk është gjetur.

Përveç skedave të prof. Elmer E. Jones, pjesëmarrësit në konferencë do të mund të njihen për herë të parë me një cikël fotografish të realizuara në Shqipëri, nga një ekspedite tjetër e zhvilluar nga studiuesit amerikanë, në fillimet e shek. XX.

Ekspedita **"Albania beautiful and primitive"** u realizua nga Dr. Elliott J. Taylor and Burta May Taylor, në vitet 1933 – 1935. Burta May Taylor, përveç videos ka realizuar edhe narracionin, i cili mungon. Ajo është një ndër dhurueset e koleksioneve më të bukura të kostumeve shqiptare në Metropolitan Muzeum.

Qëllimi i ardhjes se çiftit Taylor ishte shkolla e Kavajës, ku Burta hap shkollën e vashave (1932).

Projektuesi i shkollës së Kavajës ishte Howard R. Meyer, një ndër arkitektët dhe dezajnerët më të famshëm amerikanë të shek. XX.

Materiali i mbledhur nga autorët amerikanë në fillim të shek. XX, është një pasuri e jashtëzakonshme për kulturën dhe trashëgiminë kulturore shqiptare, jo vetëm për shqiptarët brenda trojeve shqiptare, por edhe për shqiptarët e diasporës. Edhe pse në kushte jo të mira, këto materiale duhen riparë dhe përpunuar për të mbushur atë zbrazëtirë të dokumentacionit në shkencat albanologjike dhe kulturën e trashëgiminë shqiptare, që u krijua nga mesi i shek. XX deri në ditët tona. Kjo punë kërkon angazhimin e të gjitha Institucioneve të shkencës dhe kulturës albanologjike në bashkëpunim edhe me organizatat e shqiptarëve të diasporës e veçanërisht me ato në SHBA-së.

44. Teuta ABRASHI, Prishtinë: LIDHJA NDËRMJET KUNDËRVËNIES ASPEKTORE AORIST/ IMPERFEKT DHE NYJËS SHQUESE/ JOSHQUESE

Padyshim se studimet albanistike në Amerikë kanë dhënë kontributin e tyre në shumë fusha. Kështu është edhe në fushën e studimeve gjuhësore. Për tu veçuar janë kontributet e Hamp, Newmark, Brian dhe Friedman. Shumica dërmuese e këtyre punimeve, sinkronike e diakronike, rreth gramatikës së gjuhës shqipe janë bërë në përqasje me gjuhët e tjera ballkanike. E pikërisht kjo përqasje ka edhe rëndësinë e vet sepse mund të ndihmon në shpjegimin (eventual) të dukurive gjuhësore të shqipes. Rrjedhimisht, në këtë punim do të marr për bazë një evidencë empirike të Friedman (2004: 298) rreth kundërvënies aspektore aorist/ imperfekt në gjuhën shqipe, bullgare dhe turke. Kundërvënia aspektore aorist/ imperfekt e paraqit kundërvënien e një veprimi a ngjarje të për-

funduar kundrejt një ngjarje a veprimi në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës. Sipas Friedman, lidhur me këtë kundërvënie, shqipja qëndron ndërmjet bullgarishtes dhe turqishtes. Ndër arsyet e një pozicionimi të këtillë të shqipes lidhur me kundërvënien e cekur aspektore mund të jetë edhe për shkak të dallimit ndërmjet sistemit të nyjave ndërmjet këtyre gjuhëve, sepse sipas teorisë së aspektualitetit të Verkuyl-it dhe disa gjuhëtarëve të tjerë, aspekti dhe nyja janë realizim i funksionit të njëjtë gramatikor. I pari në domenin verbal, kurse e dyta në domenin nominal. Konkretisht, një ngjarje e realizuar nga një numër i caktuar, pra i fundmë, individësh konsiderohet një ngjarje e përfunduar, kurse një ngjarje e realizuar nga një numër i pacaktuar, pra i pafundmë, individësh konsiderohet si një ngjarje e pa përfunduar apo një ngjarje në zhvillim e sipër. A realizohet ky funksion në domenin verbal apo nominal sipas Leiss (2000: 14) varet nga vendosja specifike e parametrave gramatikorë në secilën gjuhë. Meqë gjuha shqipe në sistemin e saj ka të dy nyjat: të shquar dhe jo të shquar, kurse bullgarishtja vetëm nyjën e shquar, ndërkaq turqishtja vetëm nyjën jo të shquar do të provohet të shihet se a korrespondon dallimi i sistemit të nyjave me dallimin në sistemin aspektor te këto gjuhë.

45. Valter MEMISHA, Tiranë: RRETH NDIHMESËS SË NELO DRIZARIT NË LEKSIKOGRAFINË ANGLISHT-SHQIP E SHQIP-ANGLISHT

1. Në SHBA përmbi 100 e ca vjet jeton një komunitet shqiptar që i ka dhënë kulturës sonë figura të shqua-

ra, si F. Noli, F. Konica, K. Çekrezi, Q. Panariti, P. Prifti etj. Ndër ta veçohet Nelo Drizari (1902-1976), i njohur si publicist, studiues, shkrimtar, piktor, gjuhëtar.

2. Kumtimi ynë jep informacion të shkurtër për kontributin e N. Drizarit si gjuhëtar. Ka qenë mësimdhënës i gjuhës shqipe në Universitetin "Kolumbia", është marrë me studimin shqipes. Hartoi dhe botoi veprën "Shqipja e folur dhe e shkruar. Doracak praktik" (1947), një metodë për të mësuar gjuhën shqipe nga të huajt, ndoshta i pari i këtij lloji në historinë e mësimdhënies së gjuhës sonë në botën e jashtme, duke e çuar veprën te studentët dhe më gjerë. Studiuesi N. Jorgaqi thekson për këtë vepër se "autori manifeston jo vetëm njohje të thelluar e të saktë të historisë dhe të disa prej problemeve të gjuhës shqipe, por dhe përgatitje me nivel të lartë shkencor. Ai jep një panoramë të historikut të gjuhës shqipe, të çështjeve të saj themelore, parë dhe studiuar nga gjuhëtarë të huaj e shqiptarë. Sipas tij, vëmendja shkencore ndaj shqipes nuk është e rastit, pasi ajo paraqitet si "një gjuhë moderne, me një të kaluar parahistorike."

3. Në vitin më 1934 Nelo Drizari, duke ndjekur rrugën leksikografike të çelur nga Kostandin Çekrezi (që hartoi dhe botoi në vitin 1923 ? Fjalorin anglisht shqip me …. faqe dhe … me fjalë), boton "Fjalorin shqip-anglisht dhe anglisht-shqip", i pari fjalor refleksiv (ku shqipja del si gjuhë e parë dhe si gjuhë e dytë përballë anglishtes) . Konica e vlerësonte Fjalorin për saktësinë në përkthimin e fjalëve dhe të shqiptimit të tyre, si dhe për faktin që përmbante të gjitha fjalët e doemosdoshme të gjuhës shqipe, gjë që e bën të mirëpritur "si nga studentët, ashtu dhe nga udhëtarët anglishtfolës."

4. Në vazhdim kumtesa ndalet në pasurinë leksikore e frazeologjike të shqipes për ballë anglishtes, punën përzgjedhëse për fjalësin e gjuhës sonë, në një kohë kur shqipja ende nuk kishte asnjë fjalor shpjegues të mirëfilltë. Gjithashtu, vepra çmohet për elemente të semantikës leksikore, çka duket jo vetëm te gjetja e goditur e barasvlerësve të fjalëve në gjuhët gjegjëse, por edhe elemente të sinonimisë, antonimisë, polisemisë, si dhe të sintagmatikës (shembujve ilustrues). Për shqipen këtë e realizon një gjuhëtar që e kishte atë gjuhë amtare si dhe që njihte me themel edhe anglishten e pasurinë e saj leksikore e leksikografike.

5. Vepra ka rëndësi të madhe, se jo vetëm tregon rrugën në të cilën eci leksikografia shqip-anglisht dhe anglisht shqip dhe vetë leksikografia shqipe, tregon një gjendje të caktuar të leksikut të shqipes (vjelë nga vepra të ndryshme, sidomos leksikografike dygjuhëshe, nga formimi i tij si gjuhëtar, si gazetar etj.), dhe mbi të cilin mund të ndërmerren studime leksikore, semantike, morfologjike, dialektore, historike, etnolinguistike krahasuese etj.

46. Vesel NUHIU, Prishtinë: FONETIKA E SHQIPES NGA G. S. LOWMAN

Për këtë studim autori G. S. Lowman kishte marrë shpërblimin Laura Soames për hulumtim origjinal në fonetikën e një gjuhe të gjallë, nga Kolegji Universitar i Londrës, në vitin 1930.

Studimi paraqet të dhëna të përgjithshme fonetike të gjuhës shqipe të së folmes së Shkodrës të kohës para nja tetë dekadash. Autori në fillim bën një përshkrim të shqiptimit të shqipes së kësaj treve. Është intere-

sant se ai bën fjalë për dallime shqiptimore midis folësve myslimanë dhe katolikë të trevës së Shkodrës dhe jep shpjegime për këtë dukuri.

Më tutje ai pretendon se shqipja ka 33 fonema bashkëtingëllore dhe 13 fonema zanore. Këto të dhëna do të analizohen ne kumtesë. Në vazhdim, në këtë studim flitet edhe për theksin e shqipes. Autori bën përshkrimin fonetik bukur të saktë të shqiptimit të tingujve gjuhësorë, të bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve, të gjuhës shqipe. Aty trajtohen edhe zanoret hundore dhe diftongjet e shqipes. Ofrohen edhe tekste të shqipes me përshkrim fonetik.

Në studim gjithashtu trajtohen gjatësia e zanoreve, duke dhënë vlerën e tyre fonematike, si dhe ndarja e rrokjeve dhe asimilimi i tingujve.

47. Victor FRIEDMAN, Chicago: MBI HISTORINË E SHQIPES STANDARDE NË SHTET E BASHKUARA

On the History of Standard Albanian in the United States

This paper examines the history of standard Albanian in the United States as a means of reflecting on the effects and problems of standardization for Albanian. The relation of Albanian standardization to the United States can be viewed through the lens of three categories: 1) the Émigré, 2) the Academic, and 3) the Governmental. The paper provides a history of the Albanian standard in the U.S. as reflected in these three categories from the earliest immigration, the Congress of Manastir, and the founding of *Dielli*, to Government and Academic publications, the Orthography Congress of 1972, and into the 21st century.

(Ky artikull shqyrton historinë e shqipes standard në Shtetet e Bashkuara si mjet për të reflektuar mbi efektet dhe problemet e standardizimit për shqipen. Raporti i standardizimit të shqipes me Shtetet e Bashkuara mund të shihet përmes thjerrëzave të tri kategorive: 1) i mërguari, 2)akademiku dhe 3) qeveritari. Artikulli sjell një histori të standardit të shqipes në SHBA ashtu si reflektohet në këto tri kategori nga imigrimi i hershëm, Kongresi i Manastirit dhe themelimi i Diellit, deri te botimet qeveritare e akademike, Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972 dhe në shekullin 21).

48. Zymer NEZIRI, Prishtinë: KONTRIBUTI I PROFESORËVE AMERIKANË M. PERI E A. LORD PËR EPIKËN GOJORE SHQIPTARE

Në vitet '30 të shekullit XX në Universitetin e Harvardit fillon një nismë e madhe për epikat e disa popujve të Ballkanit: "Projekt për studimin e poezisë popullore gojore jugosllave", që u hartua më 1933. U realizua nga Millmen Peri (Milman Parry), homerolog, në vitet 1934 e 1935: këngë epikë boshnjake, shqiptare, kroate dhe serbe. Në projekt mori pjesë edhe ndihmësi i tij, po ashtu nga Harvardi, Allbert Llord (Albert Lord).

Qëllimi i Perit ishte të vërtetuarit e supozimit se stili i Homerit nuk është vetëm tradicional, por është një stil gojor, që i përket poezisë gojore. Ai shënoi mbi 12 mijë tekste dhe i incizoi në rreth 3 500 pllaka gramafoni, këngë nga Pazari, Bjellopolja, Kollashini, Gacko, Stollci, Bihaqi dhe nga një pjesë e Maqedonisë.

Material më shumë rëndësi është mbledhur sidomos nga lahutarët shqiptarë në Sanxhak të Pazarit, aty ky ndeshet shqipja me boshnjakishten e me serbishten.

Peri ka meritën për epikën shqiptare, për punën me këngëtarët dygjuhësorë: Xhemajl Zogiqi, Shaban Nuhoxhiqi, Fatime Biberoviqi, Etem Hasanoviqi. Xhemajli e Hasani ishin nga Sanxhaku, kurse Fatimja e Etemi janë nga viset e tjera shqiptare. Por, dy lahutarët më të mirë ishin: Salihi nga Uglla e Pazarit, i njohur si Salih Uglanini, dhe Avdo (Avdullah) Ferizi, i njohur si Avdo Megjedoviqi nga Obrovi i Bjellopoles. Që të dy konsiderohen ndër homerët e fundit në Evropë.

Ky koleksion është kryevepër arkivore e eposeve heroike të Ballkanit dhe ndër kryeveprat arkivore botërore të letërsisë gojore.